

LIGJ
Nr.7559, datë 22.4.1992

PËR BANKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë dhe vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Banka e Shqipërisë është person juridik me qendër në Tiranë.

Neni 2

Banka e Shqipërisë përgjigjet para Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë.

Jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe në intervale 6 mujore pas kësaj, Banka e Shqipërisë i dorëzon Këshillit të Ministrave një deklaratë për politikën bankare, të cilën e boton. Në këtë deklaratë përmbahen:

- a) vlerësimi i politikës monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë për periudhën e mëparshme;
- b) politika monetare që do të ndiqet nga Banka e Shqipërisë gjatë gjashtë muajve të ardhshëm;
- c) parimet për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare për një periudhë që e cakton Banka e Shqipërisë.

Neni 3

1. Banka e Shqipërisë përgjigjet për ruajtjen e vlerës së brendshme e të jashtme të monedhës kombëtare nëpërmjet zbatimit të politikës monetare. Për këtë:

- a) Përcakton dhe nxit mekanizmat e pagesave, likuiditeteve, aftësive paguese dhe funksionet e sistemit financiar që lidhen me aktivitetin bankar në Republikën e Shqipërisë.
- b) Përcakton kushtet në emisionin e monedhës, drejton valutën në tregun e shkëmbimeve me jashtë, kushtet e kreditit duke rregulluar nevojat për kredi, kushtet financiare, duke rregulluar depozitimin e detyrueshëm të bankave të nivelit të dytë, duke vepruar si agjent fiskal dhe duke ruajtur një treg të rregullt me pjesëmarrjen aktive të letrave me vlerë.

2. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me organet shtetërore dhe, kur e çmon të arsyeshme, duke u mbështetur në dispozitat e këtij ligji, ndërmerr veprime të nevojshme për arritjen e synimeve dhe kryerjen e funksioneve të saj.

Neni 4

Bankës së Shqipërisë i jepet për mendim çdo akt normativ që i dërgohet për miratim Këshillit të Ministarave në fushën e politikës financiare e valutore.

Neni 5

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë pjesë, të bashkëpunojë dhe të nënshkruajë marrëveshje bankare me institutet ndërkombëtare financiare e bankare dhe me institutet publike e private financiare në vendet e tjera.

Neni 6

Banka e Shqipërisë jep licencë për krijimin e bankave dhe për ushtrimin e veprimtarive bankare nga entet jobankare, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre brenda e jashtë vendit.

KAPITULLI II FONDET THEMELORE DHE CAKTIMI I FITIMIT

Neni 7

Fondi i themelimit të Bankës së Shqipërisë është 500 milionë lekë.
Fondi i themelimit mund të rritet me propozimin e Bankës së Shqipërisë dhe me miratimin e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.
I tërë fondi i themelimit akordohet dhe është në dorëzani ekskluzive të shtetit. Ky fond nuk mund të transferohet ose hipotekohet.

Neni 8

Kur në bilancin e Bankës së Shqipërisë vlera e mjeteve të saj bie nën shumën e detyrimeve dhe fondit të themelimit, ministri i Financave dhe Ekonomisë transferon në Bankën e Shqipërisë tituj shtetërorë të tregtueshëm, duke zbatuar përqindjet e interesit të tregut, në shumën e nevojshme për të mbuluar mungesën.

Neni 9

Fitimi neto i Bankës së Shqipërisë, për çdo vit financiar llogaritet pasi të zbriten nga të ardhurat shpenzimet e bëra për vitin në fjalë dhe pas veçimeve për:
a) borxhe pa shpresë argëtimi, të ardhura të pasaktësuara dhe kontributin për fondin e shpërblimit të personelit;
b) shpenzime për subjekte të miratuara nga Këshilli i Ministrave për qëllime të tjera të këtij lloji, kur Banka e Shqipërisë e quan të nevojshme.

Neni 10

Banka e Shqipërisë krijon një fond të rezervës së përgjithshme. Në fund të çdo viti financiar ky fond shtohet me një shumë prej 25% të fitimeve neto të vitit, derisa fondi rezervë i përgjithshëm të arrijë në 100% të fondit të themelimit të bankës së Shqipërisë.
Me autorizim të Këshillit të Ministrave, mund të ndryshojë përqindja mbi fitimin që kalon në fondin e rezervës së përgjithshme, dhe shuma e fondit të rezervës së përgjithshme mund të rritet mbi 100% të fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 11

Pas kalimit në fondin e rezervës së përgjithshme sipas nenit 10, mbetja e fitimit neto për vitin financiar do të përdoret për të kompensuar letrat me vlerë që i janë dhënë Bankës së Shqipërisë në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.
Fitimi neto për vitin financiar, që mbetet pasi bëhen zbritjet sipas neneve 9 dhe 10 të këtij ligji, i kalon shtetit brenda katër muajsh pas mbarimit të vitit financiar.

Neni 12

Kur mjetet e Bankës së Shqipërisë do të jenë më pak se shuma e detyrimeve të saj dhe e fondit të themelimit, nuk do të bëhet asnjë transferim, shlyerje ose pagesë sipas neneve 9, 10 e 11 të këtij ligji.

KAPITULLI III VEPRIMTARITË KRYESORE TË BANKËS

Neni 13

Banka e Shqipërisë ka kompetenca dhe mban përgjegjësi në veprimtaritë e mëposhtme:

- a) të miratojë e të zbatojë politikën monetare, me qëllim që të plotësojë detyrat e përcaktuara në nenin 3;
- b) të mbikëqyrë e të rregullojë sistemin bankar të Shqipërisë me qëllim që të sigurojë veprimin dhe zhvillimin e tij;
- c) të veprojë si emetuesja e vetme e monedhës së vendit në Republikën e Shqipërisë si në kartemonedhë, ashtu edhe në monedhë metalike;
- ç) të zbatojë politikën e shtetit për kursin e këmbimit, duke përfshirë licencën, rregullimin dhe kontrollin e veprimeve të këmbimeve me jashtë;
- d) të veprojë si këshilltare për Këshillin e Ministarave për çështje ekonomike;
- dh) të skontojë kambiale, çeqe, obligacione dhe instrumente të tjera detyrimesh;
- e) të blejë e të shesë obligacione dhe letra të garantuara, të emetuara nga institucionet financiare dhe bankarë shqiptarë e banka të huaja;
- ë) të blejë e të shesë ar dhe metale të tjera të çmuara, si dhe gurë të çmuar për llogari të vet dhe për llogari të të tretëve;
- f) të blejë e të shesë mjete ndërkombëtare të pagesave, si valutë e mjete të tjera, të administrojë rezervën ndërkombëtare të shtetit dhe të ndihmojë në zgjidhjen e përshtatshme të veprimeve ndërkombëtare;
- g) t'u ofrojë kredi institucioneve bankare e financiare;
- gj) të emetojë letra me vlerë për llogari të shtetit dhe për llogari të vet;
- h) të veprojë si bankiere me institucionet financiare, qeveritë e huaja dhe agjencitë ndërkombëtare
- i) t'i japë paradhënie ose hua monetare shtetit.
- j) ruan thesarin e shtetit.

Neni 14

Banka e Shqipërisë kryen veprimtarinë e saj kryesore sipas nenit 13 të këtij ligji dhe veprimtari të tjera të parashikuara me ligj.

Banka e Shqipërisë nuk kontribuon në kapitalin neto ose në forma të tjera financimi për ndërmarrjet, në ato veprimtari që nuk përputhen me funksionet e saj, të përcaktuara sipas këtij ligji.

Neni 15

Banka e Shqipërisë regjistron dhe evidencon borxhin e jashtëm publik e privat të Shqipërisë.

KAPITULLI IV MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKAVE TË TJERA NË SHQIPËRI

Neni 16

Banka e Shqipërisë është ekskluzivisht përgjegjëse për dhënien e licencave dhe mbikëqyrjen e të gjitha enteve që veprojnë si bankë në Republikën e Shqipërisë. Për këtë, Banka e Shqipërisë:

- a) Nxjerr rregullore, urdhëra e udhëzime, si dhe jep udhëzime metodike për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar në bazë dhe për zbatim të ligjit.

b) Kontrollon çdo zyrë, regjistër, llogari dhe dokumente të bankave, si dhe të personave të tjerë, që kryejnë veprimtari bankare pa licencë. Ajo merr informacionet që i gjykon të nevojshme.

Neni 17

Banka e Shqipërisë mbikëqyr pagesat ndërkombëtare që rrjedhin nga tregëtia e jashtme, veprimet jotregtare dhe angazhimet e bankave të tjera shqiptare, që kanë lidhur kontrata me shtete, banka e shoqëri të huaja.

Neni 18

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të hapë në regjistrat e saj llogari nga bankat që kanë licencë dhe të pranojë prej tyre depozita, me afat dhe kushte që përcaktohen prej saj.

Neni 19

1. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 13 shkronja "f", skontimi dhe riskontimi i veprimeve të Bankës së Shqipërisë është i vlefshëm vetëm për bankat që mbajnë llogari në regjistrat e saj, si dhe për letrat me vlerë të mëposhtme:

a) Kambialet dhe tituj pagesë të tërhequra ose të bëra për qëllime tregtare, industriale a bujqësore, që mbajnë dy ose më shumë nënshkrime të rregullta, nga të cilat, së paku njëri prej tyre, duhet të jetë i një institucioni me licencë të depozituar. Kambialet, bëhen të vlefshme brenda 182 ditësh nga data e blerjes së tyre në Bankën e Shqipërisë.

b) Letrat me vlerë të emetuara nga organe shtetërore të caktuara dhe letrat e tjera me vlerë, të nxjerra publikisht ose të garantuara nga shteti, që formojnë pjesë të një emetimi publik dhe që maturohen brenda tre vjetësh nga data e paraqitjes së tyre te Banka e Shqipërisë.

c) Letra me vlere të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

2. Veprimet e skontimit e të riskontimit të Bankës së Shqipërisë i nënshtrohen afateve dhe kushteve të tjera që përcaktohen me rregullore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 20

Banka e Shqipërisë u jep bankave që kanë llogari në regjistrat e saj, paradhënie me afate dhe kushte që përcaktohen prej saj, por jo më tepër se 92 ditë si më poshtë:

1. Paradhënie që janë të garantuara nga:

a) instrumentet e specifikuar në pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji;

b) letra të tjera me vlerë të emetuara ose të garantuara nga shteti dhe që përbëjnë pjesë të emetimit publik;

c) dëftesa të pranuar dhe dokumente të tjera pronësie të lëshuara për mallra kryesore ose mallra të tjera të siguruara rregullisht ndaj rrezikut të humbjes ose dëmtimit;

d) depozita në Bankën e Shqipërisë ose një depozitë e pranueshme nga Banka e Shqipërisë për cdo pasuri, që ajo lejohet ta blejë, shesë ose trajtojë sipas këtij ligji.

2. Paradhënie të pagarrantuara ose që garantohen nga pasuri të tjera në afate dhe kushte që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë, për rastet që gjykohen prej saj, me qëllim që të plotësohen kërkesat për likuiditete të llogarimbajtësit dhe t'u shërbejnë interesave publike.

Neni 21

Paradhënie nga Banka e Shqipërisë për bankat e tjera u jepet vetëm drejtorive të përgjithshme të tyre në Shqipëri.

Neni 22

Afatet dhe përqindjet që zbatohen nga Banka e Shqipërisë për skontime, riskontime dhe paradhënie, si dhe përqindjet e diferencuara dhe nivelet maksimale për kategori të ndryshme

veprimesh bankare, caktohen nga Banka e Shqipërisë dhe shpallen në buletin e saj.

Neni 23

1. Banka e Shqipërisë kërkon nga bankat të mbajnë depozita pranë saj në nivele minimale të përcaktuara (rezerva të detyrueshme), që lidhen me madhësinë e fondeve ose me kategori specifike të fondeve në dispozicion të tyre.

2. Rezervat e detyrueshme mbahen në formën e likuiditeteve në arkë ose si depozitë monetare në Bankën e Shqipërisë në raporte të tilla që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë, me kusht që bankat të mos mbajnë rezerva të detyrueshme në Bankën e Shqipërisë më shumë se 20% të shumës së përgjithshme të depozitave monetare të çdo banke ose të pasivit të saj.

3. Banka e Shqipërisë mund të paguajë interes për rezervat e detyrueshme, i cili nuk mund të jetë më i madh se përqindja minimale e skontos së Bankës së Shqipërisë, të zbatuar në periudhën përkatëse.

Neni 24

1. Kur bankat nuk mbajnë rezervat e detyruara të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji, Banka e Shqipërisë vendos një gjobë deri në plotësimin e rezervës së detyruar masa e gjobës nuk duhet të kalojë dy herë përqindjen aktuale të skontos së Bankës së Shqipërisë.

2. Rregullat për rritjen e niveleve të rezervave të detyrueshme përcaktojnë dhe datën, në të cilën bankat duhet të arrijnë nivelet e reja të rezervës.

Neni 25

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me bankat, cakton rregulla për kryerjen e pagesave me çek e instrumente të tjera që përdoren si mjete pagese.

Neni 26

Banka e Shqipërisë krijon dhe mban rrjet informacioni për sistemin bankar.

Neni 27

1. Banka e Shqipërisë bashkëpunon me cilindo autoritet të huaj për mbikqyrjen bankare, mbi bazën e reciproritetit, për të mbikqyrur dhe inspektuar bankat që veprojnë direkt në juridiksionet e tyre përkatëse.

2. Banka e Shqipërisë shkëmben me autoritetet mbikqyrës bankare të huaja informacione për çdo bankë që vepron në juridiksionin e tyre përkatës, me kusht që autoritetet të marrin përsipër besueshmërinë e informacionit të marrë.

KAPITULLI V MARRËDHËNIET NDËRMJET BANKËS DHE SHTETIT

Neni 28

Banka e Shqipërisë merr nga organet shtetërore të gjitha informacionet e dokumentet financiare dhe ekonomike, që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve të saj. Banka e Shqipërisë i jep organeve shtetërore në mënyrë periodike informacione ekonomiko-financiare që kërkohen prej tij.

Neni 29

Banka e Shqipërisë përfaqëson shtetin shqiptar në të gjitha marrëdhëniet dhe veprimtaritë bankare me shtetet, bankat dhe institucionet e huaja.

Banka e Shqipërisë kryen shërbimet bankare dhe do të shërbejë si agjent fiskal për shtetin .Ky funksion nuk shpërblehet.

Banka e Shqipërisë nëpërmjet sistemit bankar kryen funksionin e arkës së buxhetit të shtetit dhe i jep informacion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 30

1. Banka e Shqipërisë pranon depozita nga shteti dhe kryen veprime pagesash deri në kufijtë e këtyre depozitave. Për këto depozita zbatohen interesa në përqindje sipas marrëveshjes ndërmjet palëve.

2. Banka e Shqipërisë mund të autorizojë ndonjë institucion tjetër financiar t'i marrë këto depozita, në përputhje me kushtet e përcaktuara prej saj.

Neni 31

Banka e Shqipërisë mund të bjerë dakord me shtetin që të veprojë si agjent për veprimet e mëposhtme:

- a) tregtimin e letrave me vlerë të emetuara nga shteti;
- b) pagesën e vleftës, të interesit dhe të shpenzimeve të tjera për letra me vlerë;
- c) kryerjen e veprimeve me kartmonedhë lidhur me llogaritë e shtetit në Bankën e Shqipërisë.

Neni 32

Banka e Shqipërisë mund t'i japë paradhënie të përkohshme shtetit. Për çdo paradhënie duhet të ketë një marrëveshje krediti ndërmjet shtetit, të përfaqësuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Bankës së Shqipërisë. Marrëveshja duhet të deklarojë qartë sasinë e paradhëniës, skadencën e saj dhe përqindjen e interesit të zbatuar.

Për këtë paradhënie Bankës së Shqipërisë i lëshohen letra me vlerë të tregtueshme nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, duke zbatuar interesat sipas përqindjeve të tregut. Afati maksimal i skadencës së këtyre letrave me vlerë do të jetë 182 ditë.

Shuma e përgjithshme e paradhënieve për çdo vit financiar nuk duhet të kalojë 10% të të ardhurave të buxhetit të shtetit për vitin e mëparshëm financiar.

Neni 33

Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3 të nenit 32 dhe dispozitat e nenit 34, Banka e Shqipërisë mund t'i japë shtetit paradhënie shtesë, me afate dhe kushte sipas marrëveshjes ndërmjet palëve, mbi shumën e caktuar për pagesat që rrjedhin nga anëtarësia e shtetit në një organizatë ndërkombëtare.

Neni 34

Shuma e përgjithshme e paradhënieve të pakthyera, siç përcaktohen në nenet 32 dhe 33, nuk duhet të kalojë shumën maksimale të vendosur nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë.

Neni 35

Letrat me vlerë të emetuara nga shteti mund të blihen dhe shiten nga Banka e Shqipërisë me shuma totale dhe afate skadence të tilla që përcaktohen nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me synimet e politikës së saj monetare.

KAPITULLI VI EMETIMI I MONEDHËS

Neni 36

Njësia monetare në Republikën e Shqipërisë është leku.

Këshilli i Ministrave përcakton formën, masat, peshën, modelin dhe karakteristikat e tjera të kartmonedhave dhe të monedhave metalike.

Neni 37

Sasia dhe procedura për eksportin dhe importin e kartmonedhave e të monedhave metalike përcaktohen nga Banka e Shqipërisë.

Neni 38

Kartmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara nga Banka e Shqipërisë dhe që nuk janë tërhequr nga qarkullimi, do të kenë kurs ligjor dhe ato pranohen për të gjitha pengesat e detyrimeve publike e private pa kufizim me vlerën e tyre nominale.

Neni 39

Banka e Shqipërisë emeton dhe hedh në qarkullim kartmonedha dhe monedha metalike që garantohen nga shteti.

Banka e Shqipërisë administron rezervën monetare, harton planet e emetimit dhe siguron furnizimin e rregullt me kartmonedha dhe monedha metalike, për të plotësuar kërkesat e shtetit për para.

Neni 40

Sasia e kartmonedhave dhe e monedhave metalike në qarkullim futen në llogarinë e Bankës së Shqipërisë si detyrime. Kartmonedhat dhe monedhat metalike të rezervës monetare nuk përfshihen në këtë detyrim.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të emetojë monedhë mbi nivelin e rezervës ndërkombëtare në përputhje me nenin 32 të këtij ligji, duke e mbuluar plotësisht nga pasuritë e mëposhtme:

- a) paradhëniet që Banka e Shqipërisë i jep shtetit dhe huatë e dhëna nga Banka e Shqipërisë që garantohen nga shteti;
- b) letrat me vlerë që mbahen në portofolin e investimeve nga Banka e Shqipërisë;
- c) mjetet që rrjedhin nga krediti që Banka e Shqipërisë i jep bankave;
- d) çeqet, kambialet dhe instrumentet e borxheve, që Banka e Shqipërisë i ka skontuar ose i mban në ruajtje.

Neni 41

Banka e Shqipërisë bën shtypjen e kartmonedhave dhe prerjen e monedhave metalike, siguron dhe mban në vende të sigurta kartmonedhat dhe monedhat metalike të paemetuara dhe ruan e asgjëson, kur është e nevojshme, pllakat dhe stampat e monedhave metalike dhe të kartmonedhave që hiqen nga qarkullimi.

Banka e Shqipërisë shkëmben pa shpenzime e komisione kartmonedhat dhe monedhat metalike të emetuara prej saj.

Neni 42

Banka e Shqipërisë sekuestron dhe konfiskon kartmonedhat dhe monedhat metalike false.

Kartmonedhat dhe monedhat e pavlefshme tërhiqen, asgjësohen dhe zëvendësohen me kartmonedha dhe monedha metalike nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë mund të refuzojë të shkëmbejë kartmonedha ose monedha metalike, po që se pamjet e tyre janë të palejueshme, jo me formë të mirë, të shpuar, ose nëse më shumë se 40% e

sipërfaqes së tyre ka humbur. Monedha të tilla tërhiqen dhe asgjësohen pa shpërblyer pronarin, me përjashtim të rasteve të veçanta, kur Banka e Shqipërisë mund të përcaktojë një kompensim të plotë a të pjesshëm.

Bankës së Shqipërisë nuk i kërkohet të japë kompensim për kartmonedhat ose monedhat metalike që kanë humbur a janë dëmtuar. Ajo mund të konfiskojë pa kompensim çdo kartmonedhë që mund të jetë ndryshuar në pamjen e jashtme, sidomos kartmonedhat, mbi të cilat është shkruar, vizatuar, shtypur, stampuar apo janë bërë vrima, ose mbi të cilën është vënë material ngjitës.

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të vendosë të mbledhë dhe të tërheqë nga qarkullimi çdo kartmonedhë a monedhë metalike që ka emetuar kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, duke emetuar në shkëmbim të tyre kartmonedha ose monedha metalike të tjera; në vendim specifikohet periudha gjatë së cilës kartmonedhat ose monedhat metalike duhet të paraqiten. Një periudhë e tillë për ndërrime nuk duhet të jetë më pak se një vit nga nxjerrja e ligjit në Fletoren Zyrtare.

Në fund të kësaj periudhe:

a) Kartmonedhat dhe monedhat metalike të mbledhura për t'u ndërruar nuk do të jenë më para në qarkullim, pavarësisht nga neni 38;

b) kartmonedhat ose monedhat metalike që janë mbledhur por që janë paraqitur për t'u këmbyer, duhet të hiqen nga sasia e monedhës në qarkullim në regjistrat e Bankës së Shqipërisë dhe të konsiderohen si të ardhura të Bankës së Shqipërisë.

KAPITULLI VII DREJTIMI, ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I BANKËS

Neni 43

Drejtimi dhe organizimi i Bankës së Shqipërisë kryhet nga këshilli i drejtuesve të departamenteve të saj dhe guvernatorit.

Kompetencat e Bankës së Shqipërisë të njohura me ligj ushtrohen nga Këshilli Drejtues dhe nga guvernatori i Bankës. Ky i fundit mund t'ia kalojë disa kompetenca të tij personave e tjerë me shkrim.

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë mban përgjegjësi për veprimtarinë e Bankës në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Guvernatori i Bankës emëron punonjësit në përputhje me strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të miratuar nga Këshilli i Drejtuesve të Bankës dhe përcakton pagat e tyre mujore.

Neni 44

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë emërohet nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit Drejtues të Bankës së Shqipërisë.

Zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë emërohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të guvernatorit të Bankës. Guvernatori dhe zëvendësguvernatorët e Bankës së Shqipërisë qëndrojnë në detyrë për një afat prej 6 vjetësh. Ata mund të riemërohen.

KËSHILLI MBIKËQYRËS I BANKËS

Neni 45

Këshilli mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë përbëhet nga guvernatori si kryetar, dy zëvendësguvernatorët dhe katër anëtarë. Një nga anëtarët emërohet nga ministri i Financave dhe Ekonomisë, ndërsa tre anëtarë të tjerë emërohen nga Presidenti me propozim të Qeverisë.

Neni 46

Këshilli mbikqyrës i Bankës është organ vendimor.

Të drejtat e detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës përcaktohen në statutin e Bankës së Shqipërisë.

Neni 47

Anëtari i Këshillit drejtues të Bankës hiqet nga detyra në qoftë se është ose bëhet:

a) bashkëshort ose pasardhës i një anëtari tjetër të Këshillit drejtues të Bankës së Shqipërisë, ose një nëpunës, drejtor ose aksioner i një shoqërie tek e cila një anëtar tjetër i këtij këshilli është nëpunës ose drejtor ose ka interes pasuror prej më shumë se 10% të kapitalit të shoqërisë.

b) nëpunës, drejtor ose aksioner i një banke ose institucioni financiar të ndryshëm nga Banka e Shqipërisë.

Neni 48

1. Guvernaotri, zëvendësguvernatorët dhe çdo anëtar i Këshillit mbikëqyrës hiqet nga detyra kur:

a) janë rastet e parashikuara në nenin 47;

b) kur dënohet për vepra të parashikuara në Kodin tonë Penal;

c) jep dorëheqjen;

d) është i paaftë të kryejë detyrën.

Neni 49

Këshilli Drejtues i Bankës ka këto të drejta e detyra:

a) miraton strukturën organizative dhe numrin e punonjësve të Bankës;

b) përcakton parimet që do të zbatohen për politikën monetare të kreditit të Bankës dhe veprimtaritë e tjera bankare;

c) propozon rritjen e fondit të themelimit të Bankës së Shqipërisë;

ç) shqyrton e miraton planin financiar dhe raportin e bilancit vjetor të Bankës;

d) miraton statutin e Bankës së Shqipërisë.

Neni 50

Anëtarët e Këshillit Drejtues të Bankës duhet t'i deklarojnë Këshillit Drejtues të Bankës interesat në veprimtarinë e tyre tregtare, financiare, bujqësore, industriale ose ndonjë lloj tjetër interesi me karakter ekonomik që ata, ose anëtarët e familjeve të tyre, mund të kenë direkt ose indirekt. Ata duhet të tërhiqen nga votimi për çdo çështje që ka të bëjë me sa më sipër, e cila bëhet objekt i veprimit të Këshillit të Bankës.

Neni 51

Anëtarët e Këshillit Drejtues të Bankës marrin një shpërblim plotësues, që përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.

KONTABILITETI DHE BILANCI I BANKËS

Neni 52

Viti financiar i Bankës së Shqipërisë fillon nga 1 janari dhe mbaron me 31 dhjetor.

Neni 53

Banka e Shqipërisë mban, në përputhje me ligjin për kontabilitetin, llogari e regjistra, që në çdo kohë duhet të pasqyrojë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

Neni 54

Guvernatori i Bankës, pasi të ketë marrë miratimin e Këshillit Drejtues të Bankës, emëron kontrolluesin e përgjithshëm të Bankës së Shqipërisë, i cili kryen detyrat në përputhje me statutin e saj.

Neni 55

Veprimet financiare të bankës revizionohen nga një komision revizionimi i veçantë, i caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Për probleme të veçanta, në bankë futet edhe kontrolli i shtetit duke ruajtur sekretin bankar për veprime të ligjshme.

Neni 56

Banka e Shqipërisë përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar dhe i paraqiten Këshillit të Ministrave nga Guvernatori i Bankës, jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të vitit financiar të Bankës.

Raporti dhe bilanci financiar i Bankës së Shqipërisë shpallen në formën e përcaktuar nga banka, pas miratimit të tyre nga Këshilli Drejtues i Bankës.

KAPITULLI VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 57

Banka e Shqipërisë ka të drejtë të marrë nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dokumente ose informacione të tjera lidhur me marrëdhëniet ndërmjet secilës prej tyre dhe Bankës së Shqipërisë.

Neni 58

Asnjë person, që është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës ose nëpunës, gjatë dhe pas largimit nga detyra, nuk lejohet të bëjë të njohur ose të publikojë pa autorizim, informacione e materiale jopublike me të cilat është njohur gjatë kohës së kryerjes së detyrës, që kanë të bëjnë me veprime bankare, vlera ose burime të ardhurash, fitime, humbje a shpenzime të Bankës së Shqipërisë. Asnjë person nuk lejohet të përdorë informata të tilla për përfitime personale; ose t'ua japë personave të paautorizuar. Për shkelje të kësaj dispozite personat mbajnë përgjegjësi sipas Kodit Penal.

Neni 59

Banka e Shqipërisë mbikëqyr, kontrollon, koordinon dhe rregullon veprimtaritë e bankave të tjera shqiptare që kanë të bëjnë me zbatimin e politikës monetare dhe të kreditit.

Neni 60

Kundër akteve të Bankës së Shqipërisë, që kanë lidhje me zbatimin e politikës monetare dhe të kreditit, mund të bëhet ankim nga subjektet e interesuara në organin shtetëror të caktuar me ligj.

Neni 61

Banka e Shqipërisë përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat.

Neni 62

Kartmonedhat që qarkullojnë me emrin "Banka e Shtetit Shqiptar", do të vazhdojnë të jenë të

vlefshme pa kufizim.

Kartmonedhat e reja do të emetohen me emrin Banka e Shqipërisë.

Neni 63

Banka e Shqipërisë ka vulën e saj me shenjat e stemës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 64

Ligji nr.7377, dt.8.5.1990 "Për Bankën e Shteti Shqiptar", shfuqizohet.

Neni 65

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.172, datë 4.5.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha